**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIVJAKË**
**DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT**
**SEKTORI BUXHETIT, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT**

**Nr 6486/1 Prot** **Divjakë më: 02/09/2024**

# RELACION
# MBI PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 PËR BASHKINË DIVJAKË
# FAZA II

Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 jemi mbështetur në ligjin **nr.139/2015 dt.17.12.2015 "**Për vetëqeverisjen vendore", në përputhje me nenet 4 dhe 24 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2025-2027, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41 datë 24.01.2024, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.3 dt.28.02.2024 **"Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"**, Udhëzimit Plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027", Ligji nr.9970 datë.24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", VKM nr.465 datë.18.07.2012 "Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm" dhe të Udhëzimit të përbashkët nr.21 datë.21.06.2013 "Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.41 datë.19.07.2024 "Për miratimin e tavaneve përfundimtarë të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Divjakë" si edhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.121 datë.18.03.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" dhe Urdhërit Plotësues Nr.284 datë 18.07.2024.

Grupi i menaxhimit strategjik ka organizuar punën së bashku me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të ngritur në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr.121 datë.18.03.2024 dhe Urdhërit Plotësues Nr.284 datë 18.07.2024. Grupi i menaxhimit strategjik në mbledhjet e organizuara ka marrë vendime për vazhdimësinë e punës për përgatitjen e Dokumentit të PBA 2025-2027 Faza II dhe Ekipet e menaxhimit të programeve në mbështetje të vendimeve të marra nga GMS ka punuar për përgatitjen e dokumentit të PBA 2025-2027 Faza II.

Adresa: Pranë Sheshit "Santa Barbara", Divjakë e-mail: info@bashkiadivjake.gov.al

**BURIMET E FINANCIMIT**

Në bazë të udhëzimit nr.3 dt.28.02.2024 "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" Udhëzimit Plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027", burimet e financimit për Bashkinë Divjakë janë si më poshtë:

| NR | Emërtimi | Plan 2025 | Plan 2026 | Plan 2027 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Të ardhurat e trashëguara | 30,000 | | |
| 2 | Transferta e pakushtëzuar | 300,025 | 317,548 | 337,181 |
| 3 | Transferta sektoriale | 175,440 | 176,846 | 178,265 |
| 4 | Të ardhurat e veta | 200,620 | 211,864 | 219,064 |
| 5 | Transferta e kushtëzuar | 667,761 | 278,200 | 288,600 |
| | **TOTALI** | **1,373,846** | **984,458** | **1,023,110** |

**TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE SEKTORIALE**

Niveli i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2025-2027, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2024. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2025-2027, paraqitet në Shtojcën 1 "Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2025-2027, bashkëlidhur udhëzimit.

| Vitet | njësia | plan 2025 | plan 2026 | plan 2027 |
|---|---|---|---|---|
| **Transferta e pakushtëzuar** | 000/lekë | 300,025 | 317,548 | 337,181 |

**Transferta e pakushtëzuar sektoriale:**

Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, për periudhën 2025-2027, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar (Shtojca nr.3).

**Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale,** sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2025-2027, do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar më buxhetin e vitit 2024. Transferta e pakushtëzuar sektoriale në vitin 2025 do të jetë në të njëjtat nivele sa në vitin 2024, në vitin 2026 do të jetë 1% më e lartë se sa në vitin 2025 dhe në vitin 2027 do të jetë 1% më e lartë se sa në vitin 2026.

në mijë lekë

| Emërtimi | Plan 2024 | Plan 2025 | Plan 2026 | Plan 2027 |
|---|---|---|---|---|
| Arsimi parashkollor (09120) | 64.261 | 64.261 | 64.904 | 65.551 |
| Arsimi parauniversitar (09230) | 1.582 | 1.582 | 1.598 | 1.614 |
| Administrimi i pyjeve (04260) | 1.057 | 1.057 | 1.068 | 1.079 |
| Ujitja dhe kullimi (04240) | 34.001 | 34.001 | 34.341 | 34.684 |
| Rrugët rurale (04520) | 9.624 | 9.624 | 9.720 | 9.818 |
| Mbrojtja nga zjarri (03280) | 15.037 | 15.037 | 15.187 | 15.339 |
| **TOTAL** | **125,562** | **125,562** | **126,818** | **128,085** |
| **Rritja e nivelit të pagave** | **19,375** | **34,878** | **34,878** | **34,878** |
| **Menaxhimi i mbetjeve (05100)** | 15.000 | 15.000 | 15.150 | 15.302 |
| **TRANSFERTA SEKTORIALE** | **159,937** | **175,440** | **176,846** | **178,265** |

## TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

**Transferta e kushtëzuar** parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta. Duke u bazuar në historikun e viteve të kaluara, parashikim i të ardhurave nga Transferta e Kushtëzuar për tre vitet e ardhshme do të jenë në këto nivele të paraqitura në pasqyrën e mëposhtme.

në 000/lekë

| Nr | EMËRTIMI PROGRAMIT | **Plan 2025** | **Plan 2026** | **Plan 2027** |
|---|---|---|---|---|
| 01170 | Gjendja Civile | **7,600** | **8,200** | **8,600** |
| 10430 | Perkujdesja Sociale, Kujdesi Social për persona të sëmurë dhe me AFTESI TE KUFIZUARA | **260,000** | **270,000** | **280,000** |
| 06370 | Furnizimi me uje per zonat bregdetare te Bashkise Divjake dhe Njesise Administrative Remas, Loti 1- Njesia Administrative Remas Viti 2021 dhe supervizioni i punimeve | **354,979** | | |
| 09120 | Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Ismail Veizi", Babunjë | **45,182** | | |
| | **GRANTI I KUSHTËZUAR** | **667,761** | **278,200** | **288,600** |

## PROGRAMET DHE TAVANËT

Sipas Udhëzimit nr.3 dt.28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", Udhëzimit Plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" dhe të **Udhëzimin nr.23 dt.30.07.2018, "Për procedurat standarde të**

**programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore**", i ndryshuar, Struktura e programeve dhe tavanet përfundimtarë 2025-2027 për Bashkinë Divjakë pasqyrohen analitikë në pasqyrën e e mëposhtëme.

Shënim: Raporti i PBA1 ku pasqyrohen Tavanet Përfundimtarë të PBA 2025-2027, janë paraqitur pa përfshirë parashikimin për Transfertën e Kushtëzuar, konkretisht transferta për fondin e Kujdesit Social për familjet dhe fëmijët, Projekti i furnizimit me ujë Njad Remas, Projekti i ndërtimit të shkollës 9-vjeçare Ismail Veizi dhe fondin e Gjendjes Civile.

Raporti i PBA2 ku pasqyrohen Burimet Buxhetore (Parashikimi i të Ardhurave), totalet janë duke përfshirë parashikimin për Transfertën e Kushtëzuar.

**"Tavanët përfundimtarë" duke përfshirë vlerën e Transfertës së Kushtëzuar:**

| Plan 2025 | Plan 2026 | Plan 2027 (në 000/lekë) |
|---|---|---|
| **1,373,846** | **984,458** | **1,023,110** |

BASHKIA DIVJAKË
TAVANËT PËRFUNDIMTARË TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027

NË 000/LEKË

| NR | EMËRTIMI PROGRAMIT | 2025 | | | | 2026 | | | | 2027 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shpenzime për paga dhe sig. shoq. | shpenzime për shërbime dhe materiale | shpenzime kapitale | Totali i shpenzimeve buxhetore | shpenzime për paga dhe sig. shoq. | shpenzime për shërbime dhe materiale | shpenzim e kapitale | Totali i shpenzimeve buxhetore | shpenzime për paga dhe sig. shoq. | shpenzime për shërbime dhe materiale | shpenzim e kapitale | Totali i shpenzime buxhetore |
| 01110 | PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM | 165,000 | 83,208 | 24,056 | **272,264** | 166,000 | 87,606 | 22,967 | **276,573** | 176,005 | 92,596 | 23,990 | **292,5** |
| 03140 | SHËRBIMET E POLICISË VENDORE | 5,900 | | | **5,900** | 6,000 | | | **6,000** | 6,100 | | | **6,1** |
| 03280 | MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE | 14,300 | 3,831 | | **18,131** | 14,500 | 3,935 | | **18,435** | 14,700 | 4,008 | | **18,7** |
| 04130 | MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK | 8,850 | 2,560 | 2,239 | **13,649** | 8,900 | 2,707 | 2,368 | **13,975** | 9,000 | 2,841 | 2,486 | **14,3** |
| 04240 | MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS, UJITJES DHE KULLIMIT | 19,960 | 19,490 | 3,067 | **42,517** | 20,000 | 19,717 | | **39,717** | 21,000 | 19,914 | | **40,9** |
| 04260 | ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE | 701 | 729 | | **1,430** | 710 | 460 | | **1,170** | 720 | 463 | | **1,1** |
| 04520 | RRJETI RRUGOR RURAL | 8,000 | 17,244 | 68,136 | **93,380** | 8,100 | 18,050 | 69,444 | **95,594** | 8,200 | 18,813 | 73,264 | **100,2** |
| 04570 | TRANSPORTI PUBLIK | | | | **0** | | | | **0** | | | | |
| 06260 | SHËRBIME PUBLIKE VENDORE | 70,500 | 21,493 | 14,809 | **106,802** | 71,000 | 23,082 | 15,654 | **109,736** | 71,500 | 23,926 | 16,383 | **111,8** |
| 05100 | MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE | | 15,000 | | **15,000** | | 15,150 | | **15,150** | | 15,302 | | **15,3** |
| 08130 | SPORT DHE ARGËTIM | 3,600 | 1,543 | | **5,143** | 3,700 | 1,630 | | **5,330** | 3,800 | 1,685 | | **5,4** |
| 08220 | TRASHËGIMIA KULTURORE EVENTE ARTISTIKE DHE KULTURORE | 8,100 | 3,627 | | **11,727** | 8,200 | 3,830 | | **12,030** | 8,400 | 3,960 | | **12,3** |
| 09120 | ARSIMI BAZË PËRFSHIRË PARASHKOLLORI | 67,000 | 7,619 | 10,796 | **85,415** | 67,200 | 2,608 | | **69,808** | 67,900 | 2,696 | | **70,5** |
| 09230 | ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM | 1,400 | 1,037 | 11,743 | **14,180** | 1,500 | 358 | 20,330 | **22,188** | 1,600 | 361 | 21,523 | **23,4** |
| 04980 | Fond Rezervë | | 9,497 | | **9,497** | | 9,498 | | **9,498** | | 9,874 | | **9,8** |
| 03280 | Fond Emergjence | | 11,050 | | **11,050** | | 11,054 | | **11,054** | | 11,500 | | **11,5** |
| **SHPENZIMET TOTALE TË BUXHETIT (Grupi 00)** | | 373,311 | 197928 | 134,846 | **706,085** | **375,810** | **199,685** | **130,763** | **706,258** | **388,925** | **207,939** | **137,646** | **734,5** |
| 01170 | GJENDJA CIVILE | 6,000 | 1,600 | | **7,600** | 7,000 | 1,200 | | **8,200** | 7,200 | 1,400 | | **8,6** |
| 10430 | PËRKUJDESJA SOCIALE, KUJDESI SOCIAL PËR PERSONA TË SËMURË DHE ME AFTËSI TË KUFIZUARA | | 260,000 | | **260,000** | | 270,000 | | **270,000** | | 280,000 | | **280,00** |
| 06370 | Furnizimi me uje per zonat bregdetare te Bashkise Divjake dhe Njesise Administrative Remas, Loti 1-Njesia Administrative Remas Viti 2021 dhe mbikeqyrja e punimeve | | | 354,979 | **354,979** | | | | | | | | |
| 09120 | Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare "Ismail Veizi" Babunjë | | | 45,182 | **45,182** | | | | | | | | |
| **GRUPI 00 DHE TRANSFERTA E KUSHTËZUAR** | | **379,311** | **459,528** | **535,007** | **1,373,846** | **382,810** | **470,885** | **130,763** | **984,458** | **396,125** | **489,339** | **137,646** | **1,023,11** |

Vlera e Tavaneve Përfundimtarë në total është e barabartë me totalin e Burimeve Buxhetore (Parashikimi i të Ardhurave), por në Raportin e PBA1 ku pasqyrohen Tavanet Përfundimtarë të

PBA 2025-2027 vlerat janë paraqitur pa përfshirë vlerat e parashikuara për Transfertën e Kushtëzuar.

**Ndaj vlerat në Raportin PBA1 janë si më poshtë:**

| Plan 2025 | Plan 2026 | Plan 2027 (në 000/lekë) |
|---|---|---|
| **706.085** | **706.258** | **734.510** |

## NDARJA E SHPENZIMEVE NË PROGRAME PËR TRE VITET E ARDHSHME

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të programeve të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të Bashkisë Divjakë, është vendosja e tavaneve të shpenzimeve. Një "tavan" në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t'u shpenzuar për një qëllim të caktuar. Ndarja e shpenzimeve për secilin program është parashikuar duke u mbështetur në Udhëzimin nr. 3 dt.28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" Udhëzimit Plotësues nr.8 datë 05.07.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" dhe të Udhëzimin nr.23 dt.30.07.2018, "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, dhe në metodologjinë e ndarjes së shpenzimeve në Buxhetin e vitit 2024.

**Për vitin 2025** është parashikuar vlera totale në 134,846 mijë lekë për shpenzime kapitale, konkretisht shpenzime për investime për vitin në fjalë. Parashikimi për ndarjen e shpenzimeve për investimet ndahet në shtatë programe, ku bejnë pjesë Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110), Mbështetje për zhvillimin ekonomik (04130), Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (04240), Rrjeti rrugor rural (04520), Shërbimet publike vendore (06260), Arsimi bazë përfshirë parashkollorin (09120) dhe Arsimi i mesëm (09230).

**Për vitin 2026** është parashikuar vlera totale në 130,763 mijë lekë për shpenzime kapitale, konkretisht shpenzime për investime për vitin në fjalë. Parashikimi për ndarjen e shpenzimeve për investimet ndahet në pesë programe, ku bejnë pjesë Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110), Mbështetje për zhvillimin ekonomik (04130), Rrjeti rrugor rural (04520), Shërbimet publike vendore (06260) dhe Arsimi i mesëm (09230).

**Për vitin 2027** është parashikuar vlera totale në 137,646 mijë lekë për shpenzime kapitale, konkretisht shpenzime për investime për vitin në fjalë. Parashikimi për ndarjen e shpenzimeve për investimet ndahet në pesë programe, ku bejnë pjesë Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi (01110), Mbështetje për zhvillimin ekonomik (04130), Rrjeti rrugor rural (04520), Shërbimet publike vendore (06260) dhe Arsimi i mesëm (09230).

Në ndarjen e shpenzimeve për investimet në fazën e dytë të PBA 2025-2025 është ndjekur e njëjta linjë investimesh si në buxhetin e vitit 2024.

## Pasqyrë e investimeve për vitet 2025, 2026, 2027

në 000/lekë

| Nr | Emërtimi i projektit ose investimit | Plani | | | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|
| | | 2025 | 2026 | 2027 | |
| 1 | Blerje baze materiale per mobilimin e Bashkise Divjake.(Kodi Projektit-1470117) | 2,000 | | | Investim I vitit 2024, me likujdim dhe në vitin 2025 |
| 2 | Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. (Kodi i Projektit-1470121) | 33,871 | 24,000 | | Investim I vitit 2024, me likujdim dhe në vitin2025, 2026 |
| 3 | Blerje çakell makinerie (1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Divjake. (Kodi i Projektit-1470122) | 7,540 | 3,502 | | Investim I vitit 2024, me likujdim dhe në vitin 2025, 2026 |
| 4 | Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruget urbane te bashkise.(Kodi i Projektit-1470106) | 616 | | | Investim I vitit 2023, me likujdim dhe në vitin 2025 |
| 5 | Blerje binderi per asfaltim e rrugeve urbane Bashkia Divjake. (Kodi i Projektit-1470107) | 5,997 | | | Investim I vitit 2023, me likujdim dhe në vitin 2025 |
| 6 | Ndertim i shkolles 9-vjecare Ismail Veizi, Babunjë. (Kodi i Projektit-1470152) | 10,796 | | | Investim I vitit 2024, me likujdim dhe në vitin 2025 |
| 7 | Mbikeqyrje punimesh: ndertim palestre te mbuluar dhe rikonstruksion i shkolles se mesme te bashkuar Cerme Sektor. (Kodi i Projektit-1470102) | | 447 | | Investim I vitit 2022, me likujdim dhe në vitin 2026 |
| 8 | Sistemim i rrugeve te brendshme te fshatit Zharnec (Kub, Ndricim, Asfaltim) | 7,000 | 7,000 | 7,000 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 9 | Sistemim i rrugeve te brendshme te fshatit Çerme Sektor (Kub, Ndricim, Asfaltim) | 7,000 | 7,000 | 7,000 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 10 | Sistemim i rrugeve te brendshme te fshatit Gradishte (Kub, Ndricim, Asfaltim) | 7,000 | 7,000 | 7,000 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 11 | Blerje materiale per zyrat e Bashkise Divjake | 1,056 | 1,967 | 2,990 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 12 | Aparat fotografik per promovimin e turizmit | 439 | | | Investim për vitin 2025 |
| 13 | Lente objektiv(24-70mm;70-200mm;200-600mm) | 300 | 391 | | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026 |
| 14 | Blerje varka per guida turistike. | | 1,000 | 313 | Investim për vitin 2026, me likujdim në vitet 2026, 2027 |
| 15 | Blerje motorra per varkat | | 977 | 2,173 | Investim për vitin 2026, me likujdim në vitet 2026, 2027 |
| 16 | Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. | 10,000 | 25,000 | 64,000 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 17 | Blerje tuba te brinjezuar, KUB dhe KUZ, Bashkia Divjake. | 6,000 | | | Investim për vitin 2025 |
| 18 | Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruge urbane dhe rurale ne Bashkine Divjake. | 4,112 | 16,942 | 9,264 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 19 | Veshje e kanaleve ujites me beton. | 3,067 | | | Investim për vitin 2025 |
| 20 | Makineri per grirjen e degeve te pemeve. | 500 | 500 | | Investim për vitin 2025, me likujdim ne vitet 2025, 2026 |
| 21 | Kosha metalik Xingato | 5,000 | | | Investim për vitin 2025 |
| 22 | Kosha metalik Xingato | | 5,000 | | Investim për vitin 2026 |
| 23 | Kosha metalik Xingato | | | 5,000 | Investim për vitin 2027 |
| 24 | Makine teknologjike per mbetjet urbane. | | 5,000 | | Investim për vitin 2026 |
| 25 | Autobot uji per pastrimin e ujrave te zeza. | 3,500 | | | Investim për vitin 2025 |
| 26 | Ndertim pike transferimi per mbetjet | 1,000 | | | Investim për vitin 2025 |
| 27 | Blerje paisje lavazho | 500 | | | Investim për vitin 2025 |
| 28 | Blerje paisje per krasitje dhe korrje bari. | 700 | | | Investim për vitin 2025 |
| 29 | Rikonstruksion i shkollave dhe palestrave ne territorin e Bashkisë Divjakë. | 11,743 | 19,883 | 21,523 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 30 | Blerje kuaj dhe karroce per shetitje turistike | 1,500 | | | Investim për vitin 2025 |
| 31 | Blerje trailer per transport mbetjesh urbane | 2,000 | 3,263 | 1,737 | Investim për vitin 2025, me likujdim në vitet 2025, 2026, 2027 |
| 32 | Blerje site rere per mirembajtjen e zones se plazhit | 1,609 | 1,891 | | Investim për vitin 2025, me likujdim ne vitet 2025, 2026 |
| 33 | Blerje materiale te ndryshme. | | | 9,646 | Investim për vitin 2027 |
| | **Totali I investimeve** | **134,846** | **130,763** | **137,646** | |

Adresa: Pranë Sheshit "Santa Barbara", Divjakë e-mail: info@bashkiadivjake.gov.al

Faza e dytë e përgatitjes së dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm përcaktohet si faza teknike e përgatitjes së buxhetit (vjetor). Faza e dytë e PBA-së konsiston në rishikimin e propozimeve për DPP dhe PSHP brenda tavaneve të fazes së dytë për shqyrtimin dfhe miratimin në Këshillin e Bashkisë Divjakë.

**Përgjegjës i Sektorit Juridik**
**Andi Bullari**

**Përgjegjëse e Buxhetit dhe MFK**
**Marinela Perriu**

**Drejtor i Financës dhe Buxhetit**
**Xheladin Brahkola**

**KRYETARI**

**Josif GORREA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA DIVJAKË -